



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIM

A.nr. 648/2016

Sokol Alihajdari

lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në vendosjen e lëndës CA nr. 374/2014, në Gjykatën e Apelit

Për: Z. Hasan Shala, Kryetar
Gjykata e Apelit në Prishtinë

Prishtinë, më 29 maj 2018

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është t'i tërhiqet vëmendja Gjykatës së Apelit, lidhur me nevojën e ndërmarjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën CA 374/2014, pa vonesa të mëtutjeshme.
2. Ky raport bazohet në ankesën individuale të z. Sokol Alihajdari, (në tekstin e mëtejshëm *ankuesi*) dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankuesit, si dhe në shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore që ka të bëjë me çështje pronësore.
3. Lënda fillimisht është iniciuar me padinë e dorëzuar më 10 qershor 2001, në Gjykatën Komunale në Prishtinë (tani Gjykata Themelore në Prishtinë), duke i kaluar të gjitha instancat gjyqësore dhe për t'u kthyer në rigjykim. Pra, ankuesi për 16 vite është në pritje të vendimit, lënda e të cilit ende nuk është vendosur përfundimisht.

Baza ligjore

4. Sipas nenit 135, paragrafi 3 të Kushtetutës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
5. Po ashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 8, përcakton se: *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave”.*

Përmbledhja e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), mund të përmbledhen si në vijim:

6. Më 10 qershor 2001, ankuesi ka parashtruar padi (C-658/01) në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për anulim kontrate mbi blerjen e banesës.
7. Më 28 qershor 2001, ankuesi ka parashtruar kërkesë për kthimin e të drejtës së posedimit të pronës në Drejtorinë për Çështje Pronësore Banësore(DÇPB). Në atë kohë, kërkesat pronësore dhe banësore për periudhën 23 mars 1989 deri 24 mars 1999, ishin kompetencë ekskluzive e Drejtorisë për Çështje Pronësore Banësore (Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60).
8. Më 31 mars 2006, Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave Pronësore Banësore, ka refuzuar kërkesën e ankuesit, dhe e ka udhëzuar atë t'i drejtohet gjykatës kompetente.
9. Më 28 korrik 2006, ankuesi, bazuar në udhëzimin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave Pronësore Banësore (HPCC/REC/60/2006/C), ka iniciuar procedurë në Gjykatën Komunale në Prishtinë
10. Ndërsa, më 11 maj 2007, ankuesi ka parashtruar kërkesë për zgjerimin e kërkesëpadisë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, (C.nr.658/01).

11. Më 17 shtator 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë, lidhur me çështjen e ankuesit ka nxjerrë Aktgjykimin C.nr.658/01, me të cilin aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e ankuesit dhe vërtetohet se ankuesi është bartës i së drejtës banesore.
12. Lënda sipas ankesës ka kaluar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë (AC.808/2008), e cila më 30 dhjetor 2011, nxjerr Aktvendim për prishjen e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.658/01, duke e refuzuar atë si çështje të gjykuar res judicata.
13. Pas paraqitjes së revizionit, më 25 shkurt 2012 në Gjykatën Supreme të Kosovës Rev.266/12, lënda është kthyer për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit, më 31.01.2014.
14. Më 14 qershor 2017, Avokati i Popullit ka pranuar ankesën e z. Sokol Alihajdari kundër Gjykatës së Apelit për zvarritje procedurale në lëndën CA 374/2014.
15. Më 14 qershor 2017, Avokati i Popullit iu drejtua Gjykatës së Apelit me kërkesë për informata lidhur me veprimet e ndërmarra dhe për ato që planifikohen të ndërmerren lidhur me lëndën e ankuesit.
16. Më 22 qershor 2017, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga Gjykata e Apelit, në të cilën thuhej se "[...] Kjo lëndë ka ardhur në Gjykatën e Apelit më 31/01/2014. Lënda është ndarë në punë dhe pret në radhë për vendosje....[...]"
17. Më 8 nëntor 2017, ankuesi njoftoi përfaqësuesen e Avokatit të Popullit, se nuk ka pasur ndonjë zhvillim nga Gjykata e Apelit, lidhur me lëndën e tij.
18. Më 15 mars 2018, Avokati i Popullit iu drejtua përsëri Gjykatës së Apelit me kërkesë për informata lidhur me veprimet e ndërmarra dhe për ato që planifikohen të ndërmerren lidhur me lëndën e ankuesit. Deri në ditën e dërgimit të këtij raporti, Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje në këtë shkresë.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

19. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21 thekson: *"Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, [...]"*.
20. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përcaktohet me nenin 31.1. të Kushtetutës: *"Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike, dhe paragrafi 2 përcakton "Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."*
21. Ndërsa, neni 32 i Kushtetutës përcakton: *"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj"*.
22. Po ashtu, Mbrojtja gjyqësore e të drejtave, në nenin 54 të Kushtetutës, përcakton: *"Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur"*.

23. Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës e përcakton Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) si dokument ligjor të zbatueshëm drejtpërdrejtë dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike¹. Prandaj, paragrafi 1 i nenit 6 i KEDNJ-ë garanton që: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor”*.
24. Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, në nenin 7 par. 2 përcakton:
- “Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor”*.
25. Ndërsa neni 7, paragrafi 5, Ligjit për Gjykatat nr. 03/L-199, përcakton se *“Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve”*.
26. Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, në nenin 10, par. 1 të po këtij ligji përcakton se: *“Gjykata ka për detyrë të përpiket që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji”*.
27. Ndërsa neni 441, paragrafi 1, shprehimisht përcakton se: *“Seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes nuk mund të shtyhet për kohë të pa caktuar”*. Paragrafi 2 i po të njëjtit nen përcakton po ashtu se: *“Seanca kryesore dëgjimore nuk mund të shtyhet më shumë se tridhjetë (30) ditë [...]”*.

Analiza ligjore

28. Ankuesi pretendon se në çështjen e tij, gjyqësori ka dështuar në sigurimin e një procesi të rregullt, të drejtë, brenda afatit të arsyeshëm ligjor dhe të drejtës për mjete efektive juridike, të paraparë me nenin 31 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6 paragrafi 1 dhe nenin 13 të KEDNJ, si dhe nenin 10 paragrafi 1 i LPK, duke u nisur nga fakti se procedura gjyqësore në çështjen e ankuesit po zgjatë për më shumë se 16 vite.
29. Avokati i Popullit përkujton se gjykata ka për detyrë që procedura gjyqësore të zbatohet, pa ndonjë zvarritje të paarsyeshme. Nga informatat në dispozicion, ankuesi me veprimet/mosveprimet e tij, nuk i ka kontribuar zvarritjes së procedurës, ndërsa zvarritjet pa një vendim përfundimtar i kanë kontribuar shkeljeve të të drejtave për mbrojtje gjyqësore, me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
30. Avokati i Popullit përkujton që, praktika gjyqësore e GJEDNJ ka vërtetuar se kohëzgjatja e procedurës llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore (shih aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003), deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih, aktgjykimin *Poitier kundër*

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22

Francës, më 8 nëntor 2005). Në rastin e ankuesit procedura gjyqësore është iniciuar më 10 qershor 2001.

31. Në raste të shumta, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
32. Po ashtu, Avokati i Populli vëren se, sipas të drejtës precedentale të GJEDNJ-së, “arsyeshmëria” e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet duke iu referuar kritereve si: kompleksiteti i rastit, sjelljet e ankuesit dhe sjelljes së autoriteteve përkatëse dhe se çfarë ishte në rrezik për aplikuesin në çështjen në fjalë” (GJEDNJ [Dhoma e Madhe], *Frydlender v. France*, Aplikimi Nr. 30979/96 (2000), par. 43, duke cituar GJEDNJ [Dhoma e Madhe], *Comingersoll S.A. v. Portugal*, Aplikimi Nr. 35382/97, par. 19 (2000), par. 19).
33. Në rastin konkret, Avokati i Popullit vëren se çështja e ankuesit mund të cilësohet si çështje komplekse, duke pasur parasysh se padia fillestare për anulim kontrate mbi blerjen e banesës, është iniciuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, më 10 qershor 2001, por meqë në atë kohë, kërkesat pronësore dhe banesore për periudhën 23 mars 1989 deri 24 mars 1999, ishin kompetencë ekskluzive e Drejtorisë për Çështje Pronësore Banësore (Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60), ankuesi më 28 qershor 2001, kishte parashtruar kërkesë edhe në Drejtorinë për Çështje Pronësore Banësore (DÇPB)². Më 12 dhjetor 2003, Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave Pronësore Banësore, kishte nxjerr vendim³ me të cilin i refuzohej kërkesa ankuesit. Edhe pas rishqyrtimit Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave Pronësore Banësore, më 31 mars 2006, kishte refuzuar kërkesën e ankuesit, dhe kishte udhëzuar atë t’i drejtohej gjykatës kompetente⁴. Kështu, ankuesi më 11 maj 2007, ka dorëzuar parashtrësë për zgjerimin e kërkesëpadisë në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
34. Prandaj, duke u nisur nga praktika gjyqësore e GJEDNJ, Avokati i Popullit vëren se, zvarritja procedurale për periudhën që nga iniciimi i padisë më 10 qershor 2001, deri me 11 maj 2007, mund të justifikohet për shkak të rrethanave. Megjithatë, periudha që nga 11 maji 2007, kur ankuesi ka paraqitur zgjerimin e padisë, e deri më tani, 11 vjet më pas, paraqet shkelje të nenit 6 të KEDNJ.
35. GJEDNJ, në rastin Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës, ka theksuar se një ndër faktorët që duhet të merret në konsideratë është edhe sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre brenda një kohë të arsyeshme. (Aktgjykim *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).
36. Sipas praktikës së GJEDNJ-së (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë

² Në bazë Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60, kërkesat pronësore ishin kompetencë ekskluzive e DÇPB, për të pranuar dhe zgjidhur ato., për periudhën 23 mars 1989-24 mars 1999.

³ Vendimi HPCC/D102/2003/A&C, dt. 12 dhjetor 2003.

pranë gjykatës kompetente, e që në rastin konkret, nisur nga rrethanat e rastit, mund të konsiderohet data 11 maj 2007, kur ankuesi ka paraqitur parashtrësën për zgjerimin e padisë në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Deri në ditën e publikimit të këtij raporti, nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar lidhur me çështjen e ankuesit.

37. Lidhur me pretendimin e ankuesit për mungesë të mjeteve efektive lidhur me shqyrtimin e zvarritjes së procedurës, Avokati i Popullit vëren se GJEDNJ në jurisprudencën e saj, e rithekson se kërkesat e nenit 13 dhe efekti i këtij neni është që të kërkojë që një dispozitë e një mjeti vendor të merret me substancën e "*një ankese të kontestueshme*" sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih, p.sh. aktgjykimi në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih, p.sh. aktgjykimi në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000). Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit përkujton se "mjetet efektive" në kuptim të nenit 13 do të duhej që ose të kishin qenë në gjendje ta parandalonin shkeljen e pohuar ose vazhdimin e saj, ose për të ofruar përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih, aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla kundër Polonisë, paragrafi 158*).
38. Prandaj, neni 13 ofron një alternativë, ashtu që një mjet ankimi është efektiv nëse mund të përdoret ose për të përshpejtuar marrjen e një vendimi nga gjykatat që shqyrtojnë çështjen, ose për t'u siguruar palëve ndërgjyqëse një adresim të përshtatshëm për vonesat që kanë ndodhur tashmë (shih *Kudla ibid.*, § 159: *Mifsud kundër Francës (GC)*, nr.57220/00, § 17, ECHR 2002-VIII)
39. Avokati i Popullit vëren se neni 13 i KEDNJ pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht dhe në mënyrë primare të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë për një individ për të siguruar që ai apo ajo gëzon të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrëjë këtë ankesë pranë një autoriteti vendor. Kërkesat e nenit 13 përkrahin ato të nenit 6 (shih, aktgjykimin *Kudla vs Polland*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimi efektiv pranë një autoriteti vendor për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6 për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme.
40. Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit përkujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë lidhur me palët kontestuese të cilat nuk kanë mjete, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit vendor ligjor (shih aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe Aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999). Në rastin e ankuesit, lënda është në pritje për vendosje në Gjykatën e Apelit, që nga 31 janar 2014, dhe nuk është zhvilluar asnjë seancë.

⁴ Vendimi HPCC/REC/60/2006, dt. 31 mars 2006.

Konstatimet e Avokatit të Populli

41. Avokati i Popullit, nga faktet, dëshmitë dhe informatat që ka në dispozicion, konstaton se zvarritja e rastit të ankuesit për 11 vite nga gjykatat, paraqet shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor, të përcaktuar dhe të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 të KEDNJ.
42. Po ashtu, Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të të drejtës për mjete efektive juridike të mbrojtura me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 13 të KEDNJ.

Prandaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”, dhe nenin 16, paragrafi 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “*Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastiit kur ka zvarritje të procedurës*”, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës:

REKOMANDON

Gjykatën e Apelit:

- ***Që pa vonesa të mëtutjeshme t’i ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën CA nr.374/2014***

Në pajtim me nenin 132 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr.05/L-019, Ju lutemi që të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni, lidhur me këtë çështje, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunim, Ju lutem që përgjigjen tuaj, në lidhje me këtë çështje ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm ligjor por jo më shumë se **tridhjetë (30) ditë** nga dita e pranimit të këtij raporti.

Me nderime,


Hilmi Jashari

Avokat i Popullit